



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 23 Dhjetor 2020

Nr: 01

UDHËZIM

PËR

**PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR DEPOZITIMIN E VERIFIKIMIN E
DOKUMENTACIONIT TË KANDIDIMIT, AFATET PËR PUBLIKIMIN E LISTAVE TË
KANDIDATËVE DHE MIRATIMIN E MODELEVE TË KANDIDIMIT**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, 64, pika 2, shkronja “e”, 67, 68, 69, 70, 71, 72, 73, dhe 92/2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe të vendimit nr.17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015”

UDHËZ O J:

KREU I

REGJISTRIMI I SUBJEKTEVE ZGJEDHORE

Neni 1

Regjistrimi i partive politike

1. Çdo parti politike, për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor për çdo lloj zgjedhje, duhet të paraqesë dokumentacionin e parashikuar në nenin 64, të Kodit Zgjedhor. Kryetari i partisë politike, në përputhje me përcaktimin e shkronjës “e”, të pikës 1, të nenit 64, duhet të paraqesë edhe deklaratën me shkrim të nënshkruar prej tij për angazhimin solemn për refuzimin për të marrë pjesë në praktika të blerjes së votës, sipas Modelit 01, bashkëlidhur këtij udhëzimi. Çdo parti politike disponon llogari bankare të posaçme për të pranuar dhurimin e fondeve jopublike, sipas pikës 2, të nenit 92/2 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të cilën e deklaron në momentin e regjistrimit, sipas Modelit 01/1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.
2. Dokumentacioni i kërkuar në nenin 64, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dorëzohet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, jo më vonë se 70 (shtatëdhjetë) ditë para datës së zgjedhjeve.



Data: 23 Dhjetor 2020

Nr. 01

“Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”

3. Administrata e KQZ-së verifikon përputhshmërinë e dokumentacionit të dorëzuar nga partitë politike me kërkesat e nenit 64, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, jo më vonë se 2 (dy) ditë nga momenti i dorëzimit të kërkesës. Në përfundim të procesit të verifikimit, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendos për regjistrimin ose mosregjistrimin e partisë politike si subjekt zgjedhor.
4. Në rast se vërehen mangësi jothelbësore në dokumentacion, administrata kontakton menjëherë me përfaqësuesin e subjektit politik dhe i kërkon korrigjimin e të metave ose kërkon nga organe të tjera shtetërore vërtetimin e të dhënave të paraqitura nga partia politike. Në rast se subjekti politik nuk plotëson të metat, i propozon Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve mosregjistrimin e partisë politike si subjekt zgjedhor.
5. Kundër vendimit të Komisionerit bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Neni 2

Regjistrimi i koalicioneve zgjedhore

1. Në përputhje me rregullat dhe afatet e përcaktuara në nenin 65, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, subjektet zgjedhore paraqesin kërkesën për t’u regjistruar si koalicion zgjedhor në KQZ. Në momentin e depozitimit të kërkesës, koalicioni, duhet të deklarojë partinë politike udhëheqëse të koalicionit dhe depoziton, njëkohësisht, edhe marrëveshjen e koalicionit.
2. Marrëveshja duhet të përmbajë, të paktën:
 - a) shprehjen e vullnetit të partive pjesëmarrëse për të qenë pjesëtare të koalicionit;
 - b) emrin e koalicionit;
 - c) shkronjat nistore të koalicionit;
 - ç) emrin, mbiemrin e personit të autorizuar nga të gjitha partitë pjesëmarrëse të koalicionit zgjedhor, i cili do të ketë të drejtën të caktojë vëzhgues në KZAZ, KQV dhe në VNV;
 - d) emrin, mbiemrin e personit të autorizuar nga të gjitha partitë pjesëmarrëse të koalicionit zgjedhor, i cili do të ketë të drejtën të përfaqësojë koalicionin gjatë procedurës së shortit në KQZ për renditjen e subjekteve zgjedhore në fletën e votimit;
 - dh) emrin, mbiemrin e personit të autorizuar nga të gjitha partitë pjesëmarrëse të koalicionit zgjedhor, i cili do të ketë të drejtën të paraqesë kërkesën për regjistrimin e koalicionit në KQZ;
 - e) numrin e kandidatëve që duhet të propozojë secila parti politike brenda koalicionit për çdo zonë zgjedhore.
3. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pas verifikimit të elementeve formale të kërkesave të neneve 65 dhe 66, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendos për regjistrimin e koalicionit zgjedhor si subjekt zgjedhor.



Neni 3

Regjistrimi i komitetit nismëtar

1. Anëtarët e komitetit nismëtar, që mbështesin një kandidat të propozuar nga zgjedhësit, duhet të depozitojnë kërkesën për regjistrim në KQZ për zgjedhjet për Kuvend ose në KZAZ për zgjedhjet e organeve të vetëqeverisjes vendore, referuar përcaktimeve të neneve 69, pika 3, e 70, pika 3, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, sipas Modelit 02, bashkëlidhur këtij udhëzimi.
2. Komisioneri ose, sipas rastit, KZAZ-ja verifikon elementet formale, përfshirë kriterin që zgjedhësit anëtarë të Komitetit Nismëtar janë votues të zonës zgjedhore përkatëse.
3. Komisioneri ose, sipas rastit, KZAZ-ja merr vendim për regjistrimin ose mosregjistrimin e Komitetit Nismëtar.

KREU II

DOKUMENTET E KANDIDIMIT

Neni 4

Dokumentet e kandidimit

1. Subjektet zgjedhore, për çdo lloj zgjedhje, në zbatim të detyrimeve që parashikojnë nenet 67, 69, 70, 72 e 92/2 duhet të paraqesin, në çdo rast, dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a) Listën shumemërore të kandidatëve me renditjen përkatëse të nënshkruar nga kryetari i partisë, kryetari i partisë udhëheqëse të koalicionit, sipas Modelit 03, bashkëlidhur këtij udhëzimi; ose propozimin nga komiteti nismëtar për të regjistruar kandidatin për deputet, kryetar bashkie ose anëtar të këshillit bashkiak, sipas Modelit 04, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Kandidatët, nëse planifikojnë të pranojnë dhurime për fushatën e tyre, hapin llogari bankare të posaçme për të pranuar dhurimin e fondeve jopublike, sipas pikës 3, të nenit 92/2, të ligjit, nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe e deklarojnë në momentin e regjistrimit të listës shumemërore të kandidatëve/kandidatit, sipas Modelit 03/1, bashkëlidhur këtij udhëzimi;
 - b) Kopjen e dokumentit të identifikimit të çdo kandidati në listë;
 - c) Deklaratën e kandidati ku të deklarohen të gjitha elementet e përcaktuara në shkronjat “b”, “c” e “ç”, të nenit 72, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, sipas Modelit 05, bashkëlidhur këtij udhëzimi;
 - ç) Sipas rastit, kopjen e deklaratës së dorëheqjes nga funksionet e përcaktuara në pikën 4, të nenit 63, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, depozituar dhe protokolluar pranë institucionit përkatës;
 - d) Vërtetimin e nënshkruar nga institucioni i Kuvendit apo njësia e vetëqeverisjes vendore, ku vërtetohet zotërimi i mandatit, të paktën 6 (gjashtë) muaj para përfundimit të mandatit të Kuvendit ose të organit të njësisë së vetëqeverisjes vendore;
 - dh) Formularin tip të nënshkruar nga zgjedhësit e zonës përkatëse që mbështesin kandidatin/partinë/koalicionin, në përputhje me nenet 69, 70 dhe 71, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, sipas Modelit 06, bashkëlidhur këtij udhëzimi;



- e) Jetëshkrimin e kandidatit, sipas Modelit 07, bashkëlidhur këtij udhëzimi;
- ë) Fotokopjen e dokumentit të identifikimit të vlefshëm, të nënshkruar nga zgjedhësi për çdo zgjedhës, në formularin tip, bashkëlidhur Modelit 06.
2. Bashkë me dokumentacionin e përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, subjektet zgjedhore, për çdo lloj zgjedhje, depozitojnë formularin e vetëdeklarimit, sipas përcaktimeve të nenit 5, të këtij udhëzimi.
 3. Në momentin e depozitimit të dokumenteve të kandidimit duhet depozituar edhe procesverbali i dorëzimit të dokumenteve, sipas Modelit 08, bashkëlidhur këtij udhëzimi.
 4. Në çdo rast, deklaratat me elementet e përcaktuara në shkronjën “a”, të pikës 1, të këtij neni, do të plotësohen sipas të dhënave në dokumentin e identifikimit të kandidatit.

Neni 5

Formulari i vetëdeklarimit

1. Për kandidatët për deputet në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë dhe zgjedhjet për organet e vetëqeverisjes vendore, partia politike depoziton në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, përveç dokumentacionit të përcaktuar në këtë udhëzim, dhe formularin e vetëdeklarimit sipas modelit të miratuar në pikën 5, të kreut III, të vendimit nr.17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015”. Për kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, formulari i vetëdeklarimit dorëzohet në KQZ nga kandidati.
2. Formulari i vetëdeklarimit, pasi nënshkruhet, dorëzohet i skanuar në format “pdf” në CD në 2 (dy) kopje.

KREU III

VERIFIKIMI I DOKUMENTACIONIT TË KANDIDIMIT

Neni 6

Verifikimi i dokumentacionit të kandidimit

1. Administrata e KQZ-së/KZAZ-së kryen verifikimin e dokumentacionit të kandidimit në lidhje me përputhshmërinë e tij me kërkesat e neneve 67, 68 dhe 72, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, duke ndjekur këtë radhë veprimi:
 - a) Evidenton nëse subjekti është parti politike/koalicion/kandidat i propozuar nga zgjedhësit, i regjistruar si subjekt zgjedhor;
 - b) Verifikon *prima facie* plotësimin e kushteve/kritereve të përcaktuara në dispozitat e neneve 67 deri 72, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, përfshirë edhe zbatimin e drejtë të kuotës gjinore;
 - c) Verifikon plotësinë e dokumenteve të kandidimit dhe të nënshkrimeve;



- ç) Në rast se konstatohet mosplotësimi i kushteve/kritereve të përcaktuara në ligjin nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, apo mungojnë dokumente, i kërkon menjëherë subjektit zgjedhor të bëjë plotësimin e dokumenteve në përputhje me procedurën e parashikuar në nenin 9, të këtij udhëzimi;
- d) Kur subjekti zgjedhor depoziton formularët e vetëdeklarimit në KZAZ, ajo ia përcjell menjëherë elektronikisht KQZ-së dhe fizikisht brenda 24 orëve.
2. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve/KZAZ-ja miraton ose refuzon listën shumëmemërore/kandidatin.
3. Administrata e KQZ-së/KZAZ-së përveç verifikimit të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, kryen dhe verifikimin e listës së zgjedhësve që mbështesin listat e kandidatëve të partisë/ve politike apo koalicionit/eve të cilat nuk zotërojnë mandat në Kuvend ose zotërojnë së bashku më pak mandate se numri i partive pjesëtare të koalicionit.

Neni 7 Verifikimi i nënshkrimeve

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve/KZAZ-ja cakton një seancë publike për verifikimin e nënshkrimeve në të cilën marrin pjesë përfaqësuesit e subjektit zgjedhor ose komitetit nismëtar, dhe/ose përfaqësuesit e subjekteve të tjera zgjedhore.
2. Në datën dhe orën e përcaktuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve/ KZAZ-ja për zhvillimin e seancës, administrata e KQZ-së/KZAZ-së disponon një kopje të formularit tip të plotësuar nga nënshkrimet mbështetëse.
3. Administrata e KQZ-së/KZAZ-së përzgjedh në mënyrë rastësore 5% të zgjedhësve nga lista e zgjedhësve që mbështesin subjektin zgjedhor përkatës të kopjes së formularit tip të nënshkrimeve.
4. Administrata e KQZ-së/KZAZ-së verifikon nënshkrimin e kandidatëve duke përcaktuar nëse nënshkruesit janë zgjedhës me vendbanim në zonat zgjedhore përkatëse në momentin e depozitimit.
5. Numri i nënshkrimeve të rregullta pjesëtohet me numrin që përfaqëson 5% të të gjitha nënshkrimeve të paraqitura. Numri që del nga ky pjesëtim shumëzohet me numrin e nënshkrimeve të paraqitura. Rezultati që del nga këto veprime përfaqëson numrin e nënshkrimeve të rregullta në listën e paraqitur.
6. Lista pranohet kur numri i nënshkrimeve të rregullta është të paktën sa numri minimal i kërkuar për nënshkrimet, sipas ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.



7. Në përfundim të procesit të verifikimit të nënshkrimeve, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve/KZAZ-ja miraton ose refuzon aktin përkatës administrativ, ndaj të cilit mund të bëhet ankim nga subjekti i interesuar në KAS, brenda 3 (tre) ditëve nga data e nxjerrjes së aktit.

Nenin 8

Verifikimi i formularit të vetëdeklarimit

1. Administrata e KQZ-së verifikon të dhënat në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin nr.138/2015 dhe vendimin e Kuvendit nr.17/2016.
2. Administrata e KQZ-së, si rregull, brenda 72 orëve nga dorëzimi i formularëve të vetëdeklarimit, evidenton rastet e refuzimit apo të mosparaqitjes së formularit të vetëdeklarimit. Refuzimi për të dorëzuar formularin e vetëdeklarimit ose mosparaqitja e formularit të vetëdeklarimit përbën shkak për refuzimin e regjistrimit të kandidatit në zgjedhje nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.
3. Vendimi për refuzimin e regjistrimit të kandidatit nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i njoftohet, menjëherë, subjektit zgjedhor, Komitetit Nismëtar ose kandidatit të propozuar nga zgjedhësit. Në zgjedhjet për organet e vetëqeverisjes vendore vendimi për refuzimin e regjistrimit të kandidatit i njoftohet menjëherë KZAZ-së që administron e vetme zgjedhjet për një bashki, për vazhdimin e procedurave për regjistrimin e kandidatëve. Vendimi i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për refuzimin e regjistrimit, në rastet e kandidatëve të propozuar nga subjektet zgjedhore, përmban dhe sqarimin për të drejtën e subjektit për zëvendësimin kandidaturës, jo më vonë se 42 (dyzet e dy) ditë para datës së zgjedhjeve.
4. Në varësi të rezultatit të verifikimit të formularëve të vetëdeklarimit, administrata i paraqet për miratim Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, projektaktin përkatës, sipas përcaktimeve në nenin 10, të ligjit nr.138/2015.

Neni 9

Kthimi për plotësim dhe miratimi i dokumentacionit zgjedhor

1. KQZ-ja ose, sipas rastit, KZAZ-ja verifikon rregullsinë e dokumentacionit të kandidimit dhe, nëse vëren parregullsi apo mospërmbushje të kërkesave të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ia kthen ato subjekteve zgjedhore për korrigjim, jo më vonë se 45 (dyzet e pesë) ditë përpara datës së zgjedhjeve.
2. Dokumentacioni i korrigjuar depozitohet jo më vonë se 42 (dyzet e dy) ditë përpara datës së zgjedhjeve. Vendimi për miratimin ose refuzimin e dokumentacionit përfundimtar merret brenda 48 orëve nga depozitimi i tyre.
3. Administrata e KQZ-së/KZAZ-së, si rregull, jo më vonë se 24 orë nga ridepozitimi, verifikon dokumentacionin e plotësuar. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve/KZAZ-ja vendos për miratimin ose refuzimin e dokumentacionit të kandidimit, jo më vonë se 24 orë.



Neni 10
Vendosja e sanksioneve

1. Në rast se listat shumemërore të kandidatëve të një partie politike nuk përmbushin një nga kushtet e përcaktuara në nenin 67, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve refuzon regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve të partisë politike/koalicioni duke zbatuar sanksionet e parashikuara në nenin 175, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim nga subjekti i interesuar në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga data e nxjerrjes së aktit.

KREU IV
AFATET PËR PUBLIKIMIN E LISTËS SË KANDIDATËVE

Neni 11
Afatet për publikimin e listës së kandidatëve

1. Pas mbarimit të afatit të ankimimeve në Kolegjin Zgjedhor, KQZ-ja publikon listën e plotë të kandidatëve në media elektronike e sociale, si dhe në faqen e saj zyrtare në internet.
2. Një kopje e listës për çdo zonë zgjedhore i dërgohet prefektit, Këshillit të Qarkut dhe KZAZ-ve. Prefekti dhe Këshilli i Qarkut e publikojnë listën shumemërore të zonës zgjedhore të qarkut përkatës në mediat vendore të cilat kanë mbulimin më të gjerë me sinjal në qark dhe e shpallin në vende publike në zonën e tyre. KZAZ-të përkatëse, menjëherë pas marrjes së listës shumemërore nga KQZ-ja, i afishojnë në hyrjen e selisë së tyre.

Neni 12
Dispozita të fundit

1. Udhëzimi nr.2, datë 29.1.2013, i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, “Për caktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit dhe afatet për publikimin e listave të kandidatëve”, i ndryshuar dhe vendimi nr. 32, datë 6.3.2015, i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, “Për miratimin e disa rregullave për regjistrimin e koalicioneve zgjedhore në KQZ”, shfuqizohen.
2. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Ilirjan CELIBASHI



Data: 23 Dhjetor 2020

Nr. 01

“Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”

7

Deklaratë e angazhimit për përkushtimin për të konkurruar në mënyrë të ndershme në zgjedhjet për _____ të datës __/__/20__.

Bazuar në nenin 64, pika 2, germa “e”, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, në cilësinë e Kryetarit të Partisë Politike _____, unë z./zj. _____

(emri zyrtar i partisë)

(emri i kryetarit/es të partisë)

DEKLAROJ

Angazhimin solemn të Partisë _____, se asnjë nga pjesëtarët e strukturave drejtuese dhe administrative, të anëtarësisë, kandidatëve për deputetë/ drejtues/ anëtarë të organeve të qeverisjes vendore, deputetë/ drejtues/ anëtarë të organeve të qeverisjes vendore dhe gjithë strukturave të tjera të angazhuara nga subjekti në këto zgjedhje, funksionarë / ish funksionarë publik do të refuzojnë të marrin pjesë në praktikën të blerjes së votës, marrjes së financimeve apo përfitimeve të kundërligjshme, veçanërisht nga ato që vijnë nga aktivitete kriminale.

Angazhohemi të zbatojmë rregulla për të gjithë anëtarësinë, administratën dhe ndjekësit tanë që: Të mos premtojnë/ ofrojnë/ japin para, mallra, shërbime dhe/ ose nxisim premtime për punësim apo trajtime të tjera të veçanta votuesve dhe/ të tjerëve, duke përfshirë familjet e votuesve apo komuniteteve të ndryshme apo të veprojnë në mënyrë të tillë që synohet të ndikojë, ose arsyeshëm pritet të ndikojë në mënyrën se si votuesit japin votën e tyre;

- Të zbatojmë parimet bazë të trashëgimisë zgjedhore europiane për votim universal, të barabartë, të lirë, të fshehtë, dhe të drejtpërdrejtë;
- Të respektojë të drejtat dhe liritë politike të shtetasve, organizatave, partive politike, për të promovuar dhe debatuar çështje politike;
- Të mos përfshihemi në praktika kërcënuese ose pengimi për të ushtruar të drejtën e votës dhe shprehjen e lirë të vullnetit të zgjedhësve.

Të bëjmë publike në kohë reale pranë KQZ-së dhe faqen zyrtare të subjektit tonë politik çfarëdolloj donacioni si dhe të refuzojmë dhurime në mjete monetare apo në natyrë që:

- Tejkalojnë limitin e përcaktuar për donacion;
- Janë kontribute në para apo në natyrë me prejardhje nga burime të ndaluara që përfshijnë edhe të ardhurat nga krimi, individë, kompani të huaja nga vende me origjinë të dyshimtë/ të parajsave fiskale;
- Janë donacione të cilat nënkuptojnë apo perceptohen si favorizime për dhënie kontrata publike, emërimë në funksione publike apo përfitime të tjera që shkojnë në emër e për llogari të dhuruesit.

Kryetari i Partisë

(emër, mbiemër, firma)

DEKLARATË E PARTISË POLITIKE

(plotëso emrin e
Partisë politike)

për zgjedhjet _____, të datës _____.20____,

Bazuar në nenin 92/2 pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

Unë _____ kryetari i partisë politike ose person i autorizuar prej tij,
_____ deklaroj se kam hapur llogari të posaçme me numër
_____ pranë Bankës _____.

Autorizoj Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe të ngarkuarit e saj për të marrë drejtpërdrejt nga banka të dhëna për të gjitha transaksionet e llogarisë.

TIRANË

Emër, mbiemër, firma

Për regjistrimin e Komitetit Nismëtar në zgjedhjet për
 _____, të datës _____.20__

- Kërkuesit:**
1. _____
 (emri, atësia, mbiemri)
2. _____
 (emri, atësia, mbiemri)
3. _____
 (emri, atësia, mbiemri)
4. _____
 (emri, atësia, mbiemri)
5. _____
 (emri, atësia, mbiemri)
6. _____
 (emri, atësia, mbiemri)
7. _____
 (emri, atësia, mbiemri)
8. _____
 (emri, atësia, mbiemri)
9. _____
 (emri, atësia, mbiemri)

Objekti: Kërkesë për regjistrimin e Komitetit Nismëtar

Bazuar në nenet 69, pika 3 dhe 70 pika 3 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, po paraqesim kërkesën për tu regjistruar në KQZ me cilësinë e Komitetit Nismëtar, për organizimin e punës për mbledhjen e firmave mbështetëse për regjistrimin si kandidat të z/zj. _____, në zgjedhjet për _____, të datës _____.20__

Anëtarët e Komitetit Nismëtar

Firma

- | | |
|----------|-------|
| 1. _____ | _____ |
| 2. _____ | _____ |
| 3. _____ | _____ |
| 4. _____ | _____ |
| 5. _____ | _____ |
| 6. _____ | _____ |
| 7. _____ | _____ |
| 8. _____ | _____ |
| 9. _____ | _____ |

Kërkesë për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet/ kryetar bashkie/ anëtar në këshillin bashkiak për zonën zgjedhore Qarku _____ / Bashkia _____, të partisë / koalicionit _____

Bazuar në nenet 67, pikat 1, 2, 3, 4, 5, 6, neni 72, pikat 2, gemma "a", të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe ligjin nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe vendimi kuvendit nr. 17/2016 të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", parages listën shumemërore të kandidatëve për deputet/ kryetar bashkie /anëtarë në këshillin bashkiak të Partisë/ koalicionit _____, në zgjedhjet _____, të datës _____.20____, me këtë renditje:

| Nr. | Emër | Atësia | Amësia | Mbiemri | Gjinia M/F | Datëlindja Data- muaji - viti | Vendlindja | Subjekti Politik | Funksioni për të cilin kandidon: deputet/kryetar bashkie/anëtar këshilli bashkiak |
|-----|------|--------|--------|---------|---------------|-------------------------------------|------------|------------------|---|
| 1 | | | | | | | | | |
| 2 | | | | | | | | | |
| 3 | | | | | | | | | |
| 4 | | | | | | | | | |
| 5 | | | | | | | | | |
| 6 | | | | | | | | | |
| 7 | | | | | | | | | |
| 8 | | | | | | | | | |
| 9 | | | | | | | | | |
| 10 | | | | | | | | | |
| 11 | | | | | | | | | |
| 12 | | | | | | | | | |
| 13 | | | | | | | | | |
| 14 | | | | | | | | | |
| 15 | | | | | | | | | |
| 16 | | | | | | | | | |
| 17 | | | | | | | | | |
| 18 | | | | | | | | | |

Kjo listë mbyllet me numër rendor: _____ (me shifra) _____ (me fjalë) _____ Kryetari i Partisë/ përfaqësuesi i Koalicionit: _____ ose personit të autorizuar prej tyre

_____ (emër, mbiemër, firma)

VVLLA

Vazhdimi i listës shumemërore të kandidatëve për deputet/ kryetar bashkie/ anëtar në këshillin bashkiak për zonën zgjedhore Qarku _____ / Bashkia _____, të Partisë / koalicionit _____

| Nr. | Emër | Atësia | Amësia | Mbiemri | Gjinia M/F | Datëlindja Data - muaji - viti | Vendlindja | Subjekti Politik | Funksioni për të cilin kandidon: deputet/kryetar bashkie/anëtar këshilli bashkiak |
|-----|------|--------|--------|---------|---------------|--------------------------------------|------------|------------------|---|
| 19 | | | | | | | | | |
| 20 | | | | | | | | | |
| 21 | | | | | | | | | |
| 22 | | | | | | | | | |
| 23 | | | | | | | | | |
| 24 | | | | | | | | | |
| 25 | | | | | | | | | |
| 26 | | | | | | | | | |
| 27 | | | | | | | | | |
| 28 | | | | | | | | | |
| 29 | | | | | | | | | |
| 30 | | | | | | | | | |
| 31 | | | | | | | | | |
| 32 | | | | | | | | | |
| 33 | | | | | | | | | |
| 34 | | | | | | | | | |
| 35 | | | | | | | | | |
| 36 | | | | | | | | | |
| 37 | | | | | | | | | |
| 38 | | | | | | | | | |
| 39 | | | | | | | | | |
| 40 | | | | | | | | | |
| 41 | | | | | | | | | |
| 42 | | | | | | | | | |
| 43 | | | | | | | | | |

Kjo listë mbyllet me numër rendor: _____ (me shifra) (_____ (me fjalë)) Kryetari i Partisë/ përfaqësuesi i Koalicionit ose personit të autorizuar prej tyre _____

VUIA

Vazhdimi i listës shumemërore të kandidatëve për deputet/ kryetar bashkie/ anëtar në këshillin bashkiak për zonën zgjedhore Qarku _____ / Bashkia _____, të Partisë / koalicionit _____

| Nr. | Emër | Atësia | Anësia | Mbiemri | Gjinia M/F | Datëlindja Data- muaji - viti | Vendlindja | Subjekti Politik | Funksioni për të cilin kandidon: deputet/kryetar bashkie/anëtar këshilli bashkiak |
|-----|------|--------|--------|---------|------------|-------------------------------------|------------|------------------|--|
| 44 | | | | | | | | | |
| 45 | | | | | | | | | |
| 46 | | | | | | | | | |
| 47 | | | | | | | | | |
| 48 | | | | | | | | | |
| 49 | | | | | | | | | |
| 50 | | | | | | | | | |
| 51 | | | | | | | | | |
| 52 | | | | | | | | | |
| 53 | | | | | | | | | |
| 54 | | | | | | | | | |
| 55 | | | | | | | | | |
| 56 | | | | | | | | | |
| 57 | | | | | | | | | |
| 58 | | | | | | | | | |
| 59 | | | | | | | | | |
| 60 | | | | | | | | | |
| 61 | | | | | | | | | |
| 62 | | | | | | | | | |
| 63 | | | | | | | | | |
| 64 | | | | | | | | | |
| 65 | | | | | | | | | |
| 66 | | | | | | | | | |
| 68 | | | | | | | | | |

Kjo listë mbyllet me numër rendor: _____ (me shifra) _____ (me fjale) _____ Kryetari i Partisë / përfaqësuesi i Koalicionit ose personit të autorizuar prej tyre _____

(emër, mbiemër, firma)

VULA

Vazhdimi i listës shumemërore të kandidatëve për deputet/ kryetar bashkie/ anëtar
në këshillin bashkiak për zonën zgjedhore Qarku _____ / Bashkia _____,
të Partisë / koalicionit _____

| Nr. | Emër | Atësia | Amësia | Mbiemri | Gjinia M/F | Datëlindja Data- muaji - viti | Vendlindja | Subjekti Politik | Funksioni për të cilin kandidon: deputet/kryetar bashkie/anëtar këshilli bashkiak |
|-----|------|--------|--------|---------|---------------|-------------------------------------|------------|------------------|---|
| 69 | | | | | | | | | |
| 70 | | | | | | | | | |
| 71 | | | | | | | | | |
| 72 | | | | | | | | | |
| 73 | | | | | | | | | |
| 74 | | | | | | | | | |
| 75 | | | | | | | | | |
| 76 | | | | | | | | | |
| 77 | | | | | | | | | |
| 78 | | | | | | | | | |
| 79 | | | | | | | | | |
| 80 | | | | | | | | | |
| 81 | | | | | | | | | |
| 82 | | | | | | | | | |
| 83 | | | | | | | | | |
| 84 | | | | | | | | | |
| 85 | | | | | | | | | |
| 86 | | | | | | | | | |
| 87 | | | | | | | | | |
| 88 | | | | | | | | | |
| 89 | | | | | | | | | |
| 90 | | | | | | | | | |

Kjo listë mbyllet me numër rendor: _____
(me shifra) (me fjalë)
Kryetari i Partisë/ përfaqësuesi i Koalicionit
ose personit të autorizuar prej tyre

_____ (emër, mbiemër, firma)

VULA

DEKLARATË

e kandidatit të listës shumemërore
Partia Politike/ Koalicioni

e kandidatit të propozuar nga
zgjedhësit

(Përzgjidh me X)

(Plotëso emrin e partisë politike/koalicionit/ kandidatit të propozuar nga zgjedhësit)

Zona Zgjedhore Qarku _____ Bashkia _____

në zgjedhjet _____, të datës _____,

Bazuar në nenin 92/2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

Unë _____ kandidat i listës shumemërore i partisë politike / koalicionit _____ deklaroj se kam hapur llogari të posaçme me numër _____, pranë Bankës _____;

Unë _____ kandidat i propozuar nga zgjedhësit deklaroj se kam hapur llogari të posaçme me numër _____, pranë Bankës _____;

Referuar nenit 92/2, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, autorizoj Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe të ngarkuarit e saj për të marrë drejtpërdrejt nga banka të dhëna për të gjitha transaksionet e llogarisë

Emër, mbiemër, firma

Për regjistrimin e kandidatit të propozuar nga zgjedhësit në zgjedhjet
për _____, të datës __. __.20__ zonën
zgjedhore _____ Qarku _____ / Bashkia _____

Objekti: Kërkesë për regjistrimin e kandidatit

Bazuar në nenet 69, 70 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, po paraqesim për regjistrim si kandidat për një deputet/ kandidatin / kryetar të bashkisë ose kandidat për këshillin vendor në zonën zgjedhore _____ Qarku _____ /Bashkia _____, në zgjedhjet _____, të datës __. __.20__ të, Z/ZJ _____, pasi kemi marrë mbështetjen e _____ zgjedhësve të përfshirë në ekstraktin e përbërësve zgjedhorë në zonën zgjedhore përkatëse.

Bashkëlidhur paraqesim listën me nënshkrimet e zgjedhësve, emrat e të cilëve janë të përfshirë në ekstraktin e përbërësve zgjedhorë, të zonës zgjedhore _____.

Anëtarët e Komitetit Nismëtar

Firma

- | | |
|----------|-------|
| 1. _____ | _____ |
| 2. _____ | _____ |
| 3. _____ | _____ |
| 4. _____ | _____ |
| 5. _____ | _____ |
| 6. _____ | _____ |
| 7. _____ | _____ |
| 8. _____ | _____ |
| 9. _____ | _____ |

DEKLARATË E KANDIDATIT

| | | | |
|---|-----------------------------|---|------------------------------------|
| | Propozuar nga zgjedhësit | Lista shumemërore Partia Politike | Lista shumemërore Koalicioni |
| (Përzgjidh me X) | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| (plotëso emrin e subjektit zgjedhor) | _____ | | |

Zona Zgjedhore/Qarku _____ Bashkia _____

Deklaruesi: _____
(emër, atësi, mbiemër)

Datëlindja | | | | | | | | | | | | | | | |

(datë - muaj - vit)

Adresa: _____

(Rruga, nr. godine, njësia administrative, qyteti)

Telefoni: | | | | | | | | | | | | | | | |

Gjinia F M

Bazuar në nenet 69 pika 2, 70 pika 2, 72 pika 2, geramat "b", "c" dhe "ç", të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

Deklaroj nën përgjegjësinë time personale se gëzoj të drejtën dhe pranoj të kandidoj si kandidat i mbështetur nga zgjedhësit në zonën zgjedhore Qarku _____, Bashkia _____ dhe se nuk jam pjesë e asnjë partie apo koalicioni që konkurren në zgjedhje dhe as nuk do të mbështes haptazi apo në mënyrë të tërthortë ndonjë subjekt apo kandidat tjetër që konkurren në zgjedhje.

Deklaroj nën përgjegjësinë time personale se gëzoj të drejtën dhe pranoj të kandidoj si kandidat i listës shumë-mërore të Partisë/ Koalicioni _____ në zonën zgjedhore Qarku _____, Bashkia _____.

Bazuar në përcaktimet e nenit 63, pika 4, të Kodit Zgjedhor, deklaroj se për shkak të këtij kandidimi kam deklaruar dorëheqjen nga funksioni i _____ paraqitur pranë _____.

(emri i institucionit)

Emër, mbiemër, firma

| Formulari tip për mbledhjen e nënshkrimeve të zgjedhëseve që mbështesin kandidatin/ subjektin | | | |
|---|---|----------------------------------|--------------------------|
| Emri kandidatit/ Lista e kandidatëve të subjektit* | Funksioni për të cilin kandidon* <i>Anëtar Këshilli Bashkiak</i> | <i>Deputet/ Kryetar Bashkie/</i> | Zona Zgjedhore/ Bashkia* |
| | | | Viti* |

Deklaratë e zgjedhësit: Unë, i nënshkruari, jap pëlqimin e kandidimit të subjektit/ kandidatit të sipërcituar. Unë, jam zgjedhës në zonën zgjedhore të mësipërme dhe kam mbushur moshën / ose do të jem 18 vjeç ditën e zgjedhjeve

| # | Emër Mbiemër | Adresa | Datëlindja (dd/mm/yyyy) | Nënshkrimi | Nr. Telefonik i Kontaktit | Inicialet e identitetit të mbledhësit* |
|----|--------------|--------|-------------------------|------------|---------------------------|--|
| 1 | | | | | | |
| 2 | | | | | | |
| 3 | | | | | | |
| 4 | | | | | | |
| 5 | | | | | | |
| 6 | | | | | | |
| 7 | | | | | | |
| 8 | | | | | | |
| 9 | | | | | | |
| 10 | | | | | | |
| 11 | | | | | | |
| 12 | | | | | | |
| 13 | | | | | | |

Të dhënat në formularin-tip duhet të plotësohen me gërma kapitale të gata për tu verifikuar ose me kompjuter, sipas dokumentit identifikues të vërshtëm. Zgjedhësi që nënshkruan në formularin-tip, duhet të jetë regjistruar në zonën zgjedhore, në të cilën do të kandidojnë kandidati i propozuar nga zgjedhësit, apo nga partitë dhe koalicionet. Në çdo rast nënshkrimi në formularin-tip duhet të depozitohet personalisht nga zgjedhësi. Formulari-tip duhet të i bashkëngjitet për çdo zgjedhës që ka nënshkruar fotokopje e dokumentit identifikues të vërshtëm, të nënshkruar prej zgjedhësit.

*Të dhënat plotësohen nga komiteti nismëtar/ partia politike/ koalicioni që nuk zotërojnë mandate në Kuvend/Këshill bashkiak/kryetar bashkie ose koalicioni që zotërojnë bashkërisht një numër mandatesh më të vogël se numri i partive pjesëtare të koalicionit. Ky model plotësohet njëspansjesisht pa modifikime në përmbajtje deri në plotësimin e numrit të nevojshëm.

Komiteti Nismëtar/ Partia Politike/ Koalicioni

(Emër mbiemër, nënshkrimi)

Jetëshkrimi i kandidatit për deputet/kryetar bashkie/anëtar në këshillin e bashkisë

Emër: _____

Atësia: _____

Mbiemër: _____

Datëlindja: _____

Vendlindja: _____

Kandidat për _____ në zgjedhjet _____, të datës
_____.20 _____ zonën zgjedhore Qarku _____/Bashkia _____.

Arsimi: _____

Eksperiencia në punë: _____

Kualifikimi: _____

Aktivite shoqërore dhe politike: _____

Shënim:

- Arsimi, eksperiencia në punë, kualifikimi dhe aktivitetet duhen të renditen nga më i vonshmi në më të hershmin;
- CV duhet të plotësohet dhe firmoset nga kandidati,
- CV sillet në KQZ në letër dhe elektronikisht në format pdf nga partia ose komiteti nismëtar.

❖ Model i miratuar me vendimin e KQZ-së nr.125, datë 05.04.2017

PROCESVERBAL i dorëzimit të dokumenteve të kandidimit

I mbajtur sot, më datë _____.____.20____, ora ____:____ në KQZ / KZAZ për dorëzimin e dokumenteve të kandidimit, nga /partia/koalicioni/ komiteti nismëtar, _____ në zgjedhjet për _____, të datës _____.____.20____.

U morën në dorëzim këto dokumente:

| NR. | Emërtimi i dokumentit | Dorëzoi | | Vërejtje |
|-----|---|---------|----|----------|
| | | PO | JO | |
| 1. | Kërkesë e Partisë/Koalicionit për regjistrim kandidati/e: ose e Komitetit Nismëtar për regjistrimin e kandidatit: | | | |
| 2. | Kërkesa për regjistrimin e Listave shumemërore e partisë/koalicionit: | | | |
| 3. | Formulari Vetëdeklarimit | | | |
| 4. | Jetëshkrimi i kandidatit për deputet/ kryetar bashkie/ anëtar në këshillin e bashkisë | | | |
| 5. | Deklaratë e kandidatit për deputet /Kryetar bashkie /anëtar në këshillin e Bashkisë: | | | |
| 6. | Dokumentin identifikues, për kandidatin për deputet/kryetar bashkie /anëtar në këshillin e Bashkisë: | | | |
| 7. | Formulari Tip me nënshkrimet e 1% të zgjedhësve të zonës zgjedhore, të cilët mbështesin kandidatin: | | | |
| 8. | Vërtetim nga Kuvendi i Shqipërisë apo Këshilli i Bashkisë për zotërimin e mandatit | | | |

| Dorëzuesi i dokumenteve të kandidimit | Dokumentet e kandidimit u morën në dorëzim nga |
|--|---|
| <p style="text-align: center;">(Emër, mbiemër, firma)</p> | <p style="text-align: center;">Sektori i administrim/Arkiv të dokumentacionit në KQZ</p> <p style="text-align: center;">(Emër, mbiemër, firma)</p> |